

FJALA E DEPUTETIT ENKELEJD ALIBEAJ

E ENJTE 20 TETOR 2022

Të nderuar qytetarë shqiptarë,

Kolegë deputetë,

Asgjë triumfaliste nuk ka në diskutimin e kësaj çështjeje. Nuk do të bëj asnjë falënderim, për askënd, madje unë vetë i pari jam kokulur për këtë arritje, nëse do të arrihet në përfundim të këtij votimi hapja e plotë e dosjeve. Dhe, në fakt, kështu duhet të jetë klasa politike shqiptare sot, kokulur, 31 vjet mbas rënies së sistemit më të tmerrshëm diktatorial në glob. Duhet të jemi kokulur, në fakt, para 34 135 të burgosurve për arsye politike, para 59 009 të internuarve, para kujtimit të 7 022 prej tyre që vdiqën prej trajtimit shtazarak, 984 prej të cilëve vdiqën në burgjet e komunizmit, 6027 të pushkatuar me gjyq edhe pa gjyq, eshtrat e të cilëve nuk dihet se ku janë. 308 persona të cilët humbën aftësitë e tyre mendore nga trajtimi shtazarak.

Janë 4500 të ekzekutuar, eshtrat e të cilëve sot nuk gjenden.

Asgjë triumfaliste nuk ka sot. Nëse arrijmë, është vetëm një detyrim i vonuar, i bërë sot, nëse bëhet, dhe gjithsecili prej nesh duhet të bëjë vetëm një gjë, të heshtë dhe të ulë kokën, sepse ajo çfarë ne e kemi konsideruar hapje e plotë e dosjeve për këdo dhe për gjithsecilin, pa asnjë kusht, në fakt, nuk është vetëm simbolizmi i ndarjes me diktaturën, por është simbolizmi i ndarjes edhe me tranzicionin.

Këta 31 vjet të një politike të trazuar, të një zhvillimi social plot thika pas shpine dhe plot hipokrizi, realitet i së cilës sot shihet nga të gjithë shqiptarët, unë besoj se ky është një detyrim moral që, së pari, duhet t'ia bëjmë vetes.

Historia është ajo që nesër mund dhe, nëse është e suksesshme, duhet të na falënderojë.

E pra, hapja e dosjeve nuk bëhet thjesht dhe vetëm për të parë cilët kanë qenë bashkëpunëtorët e ish-Sigurimit. Po, hapja e dosjeve është për të parë cilët kanë qenë punëtorët e ish-Sigurimit, cilët kanë qenë prokurorët politikë, cilët kanë qenë gjyqtarët politikë, cilët kanë qenë ekzekutorët e skuadrave të pushkatimit, cilët kanë qenë ekspertët, cilët kanë qenë ata njerëz, drejtues dhe gardianë burgjesh, të cilët vdekjen e njerëzve të pafajshëm e kanë pasur bukën e tyre të përditshme!

E, pra, kjo është ajo se çfarë një detyrim moral e njerëzor gjithsecili prej nesh do të duhet ta bëjë dhe ta bëjë sot.

Po, ky është i pari çelës i një sarkofagu të madh, ku është futur i gjithë makthi i një shoqërie shqiptare, edhe i një politike shqiptare. Do të duhet ta hapim, do të duhet të gjejë kurajën gjithsecili.

Kush nuk është i kapur, kush nuk ka skelete në dollap, do të duhet ta bëjë këtë!

Në vitin 2022, vendi i cili kërkon integrimin në Europë, do të duhej ta kishte bërë këtë gjë kohë më parë, sepse është çelësi i parë jo thjesht dhe vetëm për një dëshirë vuajaliste të shpirtrave diabolikë. Jo, jo,

është shumë më tepër sesa kaq. Është, në fakt, fillimi, shpresojmë të jetë i tillë, i një procesi purifikues të kësaj shoqërie.

Të gjithë ne do të duhet ta shohim cullak, siç ka qenë, e shkuara e afërt e këtij vendi, për të kuptuar realisht se cilat janë shkaqet dhe pasojat edhe të gjendjes ku jemi sot.

Është një lidhje e drejtpërdrejtë e hipokrizisë, e harresës, e të gjithë asaj çfarë ka ndodhur në 50 vjet diktaturë dhe 30 vjet tranzicion, ku jemi sot dhe nuk shkëputemi, litar në këmbët e të gjithë shoqërisë shqiptare dhe, mbi të gjitha, e politikës shqiptare, që nuk e lë këtë vend të shkojë përpara si bota e qytetëruar!

Kjo është shpresa me të cilën të gjithë kolegët e mi të nderuar, të cilëve falënderimin do t'ua japë historia, e nënshkruan dhe e ndërmorën këtë iniciativë.

Jua thashë dhe e përsëris, nuk ka asnjëlloj triumfalizmi.

Kokulur, për atë çfarë mund të kemi pasur mundësi ta bëjmë dhe nuk e kemi bërë, por, gjithsesi, unë besoj se historia do të jetë ajo që do të na vlerësojë nesër.

Na falni, shqiptarë kudo, ju që keni vuajtur; ju, që nuk gjeni eshtrat; ju, që keni vuajtur, në fakt, në burgjet e diktaturës; ju, që keni hequr të zitë e ullirit nga prokurorë, gjyqtarë, hetues, punëtorë dhe bashkëpunëtorë të Sigurimit, që vetëm kaq vonë menduam, jo vetëm për dhimbjen tuaj, jo vetëm për eshtrat e atyre që ende nuk janë gjetur, por të paktën për brezat aktualë, të sotëm, e ka këtë vlerë! Ndjesë!